



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 266, Datë 27.10.2025

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË
“DRAGOBIA ENERGY” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “ç” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “d”, 5, pika 1, gërma “d”, 10, pikat 1 dhe 3, si dhe 16 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.10.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2516/2 prot., datë 23.10.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi kërkesën e shoqërisë “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

- Konstatohet se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 2516/1 prot., datë 16.10.2025, shoqëria “Dragobia Energy” sh.p.k. ka paraqitur kërkesën për rinovimin e licensës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike ,
- Në nenin 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, përcaktohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo me vonë se 6 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë.
- Rezulton se shoqëria “Dragobia Energy” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 98, datë 16.04.2021. (data e përfundimit të licencës nr. 488 Seria F21, është 16.04.2026) dhe shoqëria duhet të aplikonte brenda datës 16.10.2025.
- Sa konstatohet shoqëria e ka paraqitur aplikimin e saj brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1 të rregullores.
- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar, si dhe ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.

- Për sa depozituar nga shoqëria dhe në referencë të përcaktimeve të rregullores, vlerësohet se nga shoqëria duhet të depozitohet dhe sa vijon:
 - Shoqëria duhet të depozitojë vendimin e organeve drejtuese, ku të përcaktohet qartë se shuma e fondeve të nevojshme për garantimin e ushtrimit të veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike për të paktën 1 muaj, do të dedikohet posaçërisht për këtë qëllim.
 - Shoqëria duhet të sqarojë mënyrën e sigurimit të zyrave përfaqësuese për periudhën e mbetur të vlefshmërisë së licencës që kërkon të rinovohet, duke qenë se kontrata aktuale e huapërdorjes është e vlefshme vetëm deri më datë 29.07.2027 dhe nuk mbulon të gjithë afatin 5-vjeçar të licencës pas rinovimit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k., për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 98, datë 16.04.2021.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI